# NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 3 nëntor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) shqyrtoi çështje që lidhen me zhvillimin e kuadrit rregullator të sektorit të energjisë elektrike, komunitetet e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e klientëve fundorë, si dhe licencimin dhe administrimin e licencave të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në këtë sektor.

U miratuan procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të ERE-s, përkatësisht nr. 44, datë 08.10.2026; nr. 45, datë 20.10.2026 dhe nr.46, datë 26.10.2026.

## ◆ LICENCIMI DHE MONITORIMI I SUBJEKTEVE

### Vendimmarrjet e Bordit të ERE-së

**"OSMANI" sh.p.k.** – Bordi i ERE-së vendosi të nisë procedurën e licencimit të shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Shënepremte", me kapacitet të instaluar 1.860 MW, me vendndodhje në ujërat e Përroit të Moçalit të Ariut të Sharrës, degë të lumit Grabovë, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

**"ALBESP TRADING & CONSULTING" sh.p.k.** – Bordi i ERE-së vendosi ndryshimin e vendimit të licencimit, duke përcaktuar datën 1 gusht 2027 si afatin brenda të cilit shoqëria duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton të drejtën e përdorimit të ambienteve të zyrave të përfaqësuesit të furnizuesit, për periudhën e mbetur të licencës.

**"SELCA ENERGJI" sh.p.k.** – Bordi i ERE-s miratoi ndryshimin e vendimit nr. 76, datë 29.04.2024, për shoqërinë "SELCA ENERGJI" sh.p.k., duke shfuqizuar pikën 5, pasi shoqëria ka përmbushur detyrimin për zëvendësimin e gjeneratorit në HEC "Selca", me rezultat kapacitetin e instaluar prej 1.98 MW. Gjithashtu, në vijim të sqarimeve të AMBU-së se nuk ka ndryshime në parametrat dhe kushtet e lejes ekzistuese të përdorimit të burimit ujor dhe, për rrjedhojë, nuk nevojitet ndryshimi apo pajisja me leje të re, u riformulua pika 6 e vendimit, duke përcaktuar rastet në të cilat ai mund të rishikohet.

- **REGJISTRIMI I IMPIANTEVE TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Bordi i ERE-s miratoi regjistrimin e gjashtë impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, të deklaruara nga shoqëritë:

- "SPV BLUE 1" sh.p.k.: 100 MW fuqi ngarkimi dhe 400 MWh kapacitet depozitimi.

- "SPV BLUE 2" sh.p.k.: 400 MW fuqi ngarkimi dhe 1,600 MWh kapacitet depozitimi.

- "SPV BLUE 3" sh.p.k.: 50 MW fuqi ngarkimi dhe 200 MWh kapacitet depozitimi.

- "ALBANIA POWER CORE" sh.p.k.: 40 MW fuqi ngarkimi dhe shkarkimi dhe 80 MWh kapacitet depozitimi. Fuqia e injektuar në rrjet nuk duhet të tejkalojë 45,46 MW në pikën e lidhjes.

- "3X ENERGY" sh.p.k.: 72,015 MW fuqi ngarkimi dhe shkarkimi dhe 144,03 MWh kapacitet depozitimi. Fuqia aktive totale e injektuar në pikën e lidhjes nuk duhet të tejkalojë 70 MW.

- "ALBPOWER" sh.p.k.: 60 MW fuqi ngarkimi dhe shkarkimi dhe 240 MWh kapacitet depozitimi.

Regjistrimi i këtyre impianteve është kryer në kuadër të licencave ekzistuese të prodhimit ose tregtimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të regjimit kalimtar të parashikuar në ligjin nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Për impiantet e regjistruara, operimi lejohet gjatë periudhës kalimtare, deri në 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, me detyrimin për aplikimin për licencën përkatëse për vijimin e aktivitetit përtej këtij afati.r. 59/2026.

- **Mosmiratimi i kërkesave për regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike në kuadër të regjimit kalimtar**

Bordi i ERE-së vendosi të mos miratojë kërkesat e shoqërive "Akërni Solar" sh.p.k., "Armen Solar" sh.p.k., "Eco Park" sh.p.k., "Euron Solar-Pv" sh.p.k. dhe "Çalik Albania Wind" sh.p.k. për regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike (BESS) sipas regjimit kalimtar. Vendimi u mor pasi shoqëritë nuk disponojnë licencë ekzistuese në sektorin e energjisë elektrike dhe kërkesat e tyre janë paraqitur pas përfundimit të afatit 60-ditor të parashikuar në kuadrin rregullator në fuqi.

- Vlerësimi i Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë Rregullatore të TAP AG për vitin 2025

Bordi i ERE-s miratoi vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë Rregullatore të TAP AG për vitin 2025, duke konstatuar se shoqëria ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Programi i Pajtueshmërisë Rregullatore dhe se Zyrtari i Pajtueshmërisë ka ushtruar përgjithësisht në mënyrë cilësore detyrat e tij ligjore dhe funksionale.

Vendimet e plota të Bordit të ERE-s janë të aksesueshme në faqen zyrtare të ERE-s dhe publikohen në Fletoren Zyrtare, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.